

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISE CIVILE NDAJ TE TRETETE, NGA PRODUKTI.

Neni 1, Përcaktime

Kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit për përgjegjësinë civile ndaj te Tretete te shkaktuar nga Produktet e hedhura ne treg nga i Siguruari, këtu e në vazhdim do të quhen Kushtet e kontrates se Sigurimit, ose shkurt “Kushtet e Sigurimit”.

Dëshmia e sigurimit, që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet “Polica e Sigurimit”.

ALBSIG SHA është Siguruesi i kësaj kontrate sigurimi.

Policembajtesi ose Kontraktuesi” do të kuptohet personi që kryen veprime dhe nënshkruan kontratën e sigurimit për llogari dhe në emër të të Siguararit/ve.

I Siguruari është personi fizik ose juridik interesi pasuror i te cilit mbulohet me sigurim sipas ketyre kushteve sigurimi. I siguruari dhe Policembajtesi janë i njëjti person, përveç rasteve te polices per llogari te te tjereve.

Primi, është shuma e parave e paguar nga i Siguruari, perkundrejt leshimit te polices se sigurimit nga Siguruesi.

Demshperblimi, është shuma e parave e paguar nga Siguruesi te Siguararit ne pajtim me kushtet e Sigurimit.

Neni 2, Objekti i kontratës, Rreziket e Siguruara

Objekti i kësaj kontrate është marrëdhënia juridike në të cilën Siguruesi, brenda limitit të demshperblimit dhe në përputhje me këto kushte sigurimi mbulon:

- (1) Kërkesat për demshperblim të të Tretete kundrejt te Siguararit i cili mbahet pergjegjes me vendim Gjykate per shkak te defekteve ose te pamjaftueshmerise se sigurise se Produkteve te hedhura ne treg prej tij, që rezultojne me demtime dhe humbje te:
 - **Shëndetit te palëve të treta**, që nënkupton demtime fizike, sëmundjen ose vdekjen e çdo personi qe nuk është pale ne kete kontrate sigurimi (deme ne njerез);
 - **Sendeve të palëve të treta**, që nënkupton demtime fizike ose shkatërrim te pronës në zoterim të çdo personi ose enti qe nuk është pale ne kete kontrate (deme ne sende).
- (2) Pergjegjesine e te Siguararit per shkak te humbjes se shkaktuar prej çdo elementi apo njesie (bashkesi elementesh) qe i Siguarari trupezon ne produktin e tij, i cili është prodhuar dhe furnizuar nga te tjere prodhues.
- (3) Humbjet dhe demet e shkatuara nga produkte ne te cilat janë trupezuar elemente ose njesi te prodhura dhe furnizuara nga Siguruari.
- (4) Shpenzimet dhe kostot ligjore te areesyeshme e te nevojshme të të Siguararit, të kryera me marreveshjen e Siguruesin për mbrojtjen e interesave të tij gjatë procesit të gjykimit lidhur me kërkesa demshperblimi te pajustificuara e te ekzagjeruara.

Neni 3, Rreziqe te Perjashtuara

- (1) Siguruesi nuk mbulon dhe demshperblen humbje dhe demtime:
 - 1) që ne pajtim me me nje kontrate ose marreveshje te veçante kalojne kufirin e pergjegjesise referuar rregullimeve ligjore ne fuqi mbi pergjegjesine;
 - 2) nese i Siguarari shkakton aksident me qellim. Termi me qellim perfshin edhe sjelljen ose veprimet e te Siguararit i cili nuk shmang rrethana te rrezikshme, te tilla që nga veprimi ose ndikimi i tyre duhej te priteshin prishja ose defekte te mallrave, produkteve, sherbimeve;
 - 3) te vete produketeve te prodhuara e hedhura ne treg nga i Siguarari;
 - 4) per shkak te kthimit ose terheqjes se produkteve nga tregu, çmontimit, riparimit, modifikimit e rimontimit te produkteve me defekte te furnizuar nga i Siguarari.
 - 5) qe rezultojne nga produkte difektoze qe nuk jane te pershtatshme per qellimin per te cilin jane prodhuar ose realizuar;
 - 6) qe ndodhin per shkak te trajtimit(proçesimit) te mevonshem te produktit;
 - 7) per shkak te tjetersimit te produktit te te Siguararit ose prodhuesit pa dijenine e tij;
 - 8) qe rezultojne nga produkte qe i Siguarari ose prodhuesi nuk i ka prodhuar per shitje as per çdo menyre tjeter shperdarje per qellime ekonomike as nuk i ka prodhuar apo nxjerre ne treg ne kuader ose brenda kornizes se aktivitetit te tij;
 - 9) nese nuk kontrollon dhe verifikon cilesine e elementeve dhe njesive te furnizuara nga te tjeret, kur ato i trupezon ne produktin e tij;
 - 10) per shkak te gjobave, denimeve;
 - 11) te te gjitha llojeve qe nuk kane qellim kompensimi, por jane thjesht deme ndeshkimore;
 - 12) per shkak te ndikimit te fushes magnetike ose elektromagnetike, bifenilit te poliklorinuar (polychlorinated biphenyls) ose rezatimit ose ndotjes nukleare;
 - 13) per shkak te ndryshimeve gjenetike ne organizma, semundje profesionale, asbestit ose te tjera semundjeve qe direkt ose indirekt rezultojne te shkaktuara nga asbesti ose substanca qe permbajne asbest, duhane ose semundje te tjera qe rezultojne prej perdorimit (pirjes) se duhanit ose produkteve te duhanit;
 - 14) deme te personave (shendetesore) e sendeve te shkaktuara nga rrezatimi ose ndotja jonizuese nga radioaktiviteti prej karburanteve berthamore, rrjedhjeve berthamore.
 - 15) deme si pasoje e lufte, nderhyrjes se forcave te huaja ushtarake pavaresisht se lufta është shpallur ose jo, lufta civile, revolucioni, aktet terroriste, aktet e sabotzhit dhe aktet e vandalizmit.

Neni 4, Shuma e Siguaruar

- (1) Mbulimi i Siguruesit per çdo nje ngjarje te veçante ose individuale sigurimi percaktohet nga shuma e siguruar e rene dakord dhe pranuar nga palet.
- (2) Siguruesi paguan per te gjitha ngjarjet e sigurimit qe sjellin humbje e deme brenda nje viti (agregati vjetor) nje shume demshperblimi maksimalisht sa dyfishi i shumës se sigurimit te rene dakord dhe pranuar per nje ngjarje sigurimi, po te moj jete rene dakord dhe pranuar ndryshe nje shume tjeter, qe shenohet ne policen e sigurimit.
- (3) Ne rast se brenda periudhes vjetore te sigurimit Siguruesi paguan shumen totale vjetore (agregatin vjetor), Polica e sigurimit mund te mbetet ne fuqi dhe vijon mbulimin vetem nese arrihet marreveshje e vecante per vazhdimin e mbulimit. Ne kete rast nje prim shtese percaktohet veçanerisht.

Neni 5, Ngjarja ose Rasti i Sigurimit

- (1) Ngjarja ose rasti i sigurimit konsiderohet te kete ndodhe ne momentin kur ngjarja qe sjell humbjen ose demin i cili mundeson qe kunder te Siguararit te paraqitet nje kerkese per demshperblim te kete ndodhur.
- (2) Pavaresisht numrit te personave te demtuar (deme ne njerез) dhe/ose numrit te objekteve te humbur e demtuar (deme ne sende), kur te gjitha keto deme e humbje kane nje shkak te vetem ose rezultojne prej produkteve te furnizuara me te njejtin defekt ose pamjaftueshmeri sigurie (nje parti malli), konsiderohen te kene ardhur nga nje ngjarje e vetme sigurimi, e cila ndodh kur ngjarja e sigurimit te pare ndodh, pavaresisht se kur ngjarja momentale e vecante e sigurimit ndodhi apo i deklarohet te Siguararit.

Neni 6, Kufijte ose Limitet kohore te Pergjegjesise, Territori i vlefshmerise.

- (1) Siguruesi është pergjegjes vetem nese ngjarja e sigurimit ndodh pergjate periudhes se sigurimit, me kusht qe:
 - produkti me defekt ose pamjaftueshmeri sigurie te jete vendosur ose hedhur ne treg jo me heret se data e fillimit te periudhes se sigurimit te shenuar ne policen e lidhur me Albsig sh.a.;
 - i Siguarari nuk ishte ne dijeni te defekteve e pamjaftueshmerise se sigurise se produktit, dhe
 - qe humbja e demi te mos mbulohej nga çdo police tjeter ne fuqi qe ai (i Siguarari) ka perfunduar ose lidhur me te tjere Sigurues.
- (2) Albsig sh.a. nuk është pergjegjes per shkak te defekteve dhe pamjaftueshmerise se sigurise se produkteve te hedhura ne treg perpara dates se fillimit te periudhes se sigurimit te kesaj police. Nese palet bien dakord te perfshijne ne mbulim pergjegjesine per te tille raste Siguruesi do te percaktoje dhe i Siguarari do te paguaje nje prim shtese dhe ne police do te shenohet data nga e cila do te filloje pergjegjesia e Siguruesit ose retroactive date. Kjo pergjegjesi gjithashtu kushtezohet nga mosdijenja e te Siguararit per defekte, pamjaftueshmeri sigurie, apo kerkesave per demshperblim deri ne momentin e nenshkrimit te kesaj police dhe demi ose humbja te mos mbulohet nga çdo police tjeter sigurimi.
- (3) Territori i vlefshmerisë së kësaj kontrate është territori i Republikës së Shqipërisë, nese nuk është vendosur ndryshe me shenimin perkates ne police.

Neni 7, Demshperblimi, Pjesa e Zbritshme, Franshiza.

- (1) Demshperblimi është humbja e matur ne terma financiare e percaktuar ne pajtim me parashikimet e ketyre kushteve te sigurimit dhe e kufizuar ne shumen e sigurimit te rene dakord e shenuar ne police.
- (2) Vlera e demshperblimit zvoglohet me pjesen qe mbart vete i Siguarari, te shprehur me Pjesën e zbritshme në përqindje dhe/ose Franshizën në vlerë nominale mbi çdo një dëm ose seri dëmsh të ndodhura nga një rast ose ngjarje e vetme sigurimi. Pjesa e zbritshme dhe/ose Franshiza shënohen në policën e sigurimit.
- (3) Siguruesi nuk do të pagujë dëme që vlerësohen më pak se vlera e Franshizës së përcaktuar në policë. Në të gjitha rastet e tjera, ku vlera e dëmit kalon vleren e Franshizës aplikohet Pjesa e Zbritshme në %, mbi shumen e dëmshperblimit të përlogaritur për t’ju paguar të Siguararit ose Përfituesit.

Neni 8, Pershkrimi i Rrisikut ose Aktivitetit qe sigurohet (Objekti i Sigurimit)

- (1) Ne momentin e lidhjes se kontrates se sigurimit i Siguarari duhet ti zbuloje Siguruesit te gjitha rrethanat e faktet e rendesishme per pranimin ose marrjen ne sigurim te rrisikut(aktivitetit), per te cilat ai ka dijeni ose duhej te kishte dijeni.
- (2) I Siguarari duhet te njoftoje menjehere Siguruesin per cdo ndryshim te rrethanave e fakteve te cilat do te vleresoheshin te rendesishme per vleresimin e rrisikut, pergjate periudhe se sigurimit.
- (3) Nese është e nevojshme i Siguarari duhet ti mundesoje Siguruesit te inspektoje e kontrolloje rriskun (aktivitetin e siguruar).

Neni 9, Periudha e Sigurimit

- (1) Pergjegjesia e sigurimit ne baze te kontrates se sigurimit fillon ne mesnaten e dates se shenuar ne police si date e fillimit te mbulimi, nese primi i sigurimit është paguar ne llogarine e Siguruesit deri ne kete date. Perndryshe pergjegjesia e Siguruesit shtyhet deri ne mesnaten e dates se

pageses se primit te sigurimit, nese nuk eshte rene dakord ndryshe. Si rregull policat e sigurimit leshohet me afat 1 vjeçar.

- (2) Përgjegjësia e Siguruesit mbaron ne mesnaten e dates se shenuar ne police si date e skadimit te mbulimit me sigurim.
- (3) Nese ne policen e sigurimit shenohet vetem data e fillimit te polices, polica e sigurimit si dhe përgjegjësia e Siguruesit per mbulimin me sigurim dhe po ashtu përgjegjësia e te Siguarit per pagesen e primit rinovohet nga nje vit ne tjetrin, duke filluar ne heq dore nga kontrata me njoftim me shkrim nga palet heq dore nga kontrata e sigurimit me njoftim me shkrim pales tjetet, te pakten 3 muaj perpara mbarimit te mbarimit te periudhes se sigurimit ne vitin aktual ose ne vijim. Nese polica lidhet me afat me shume se 3 vjet secila pale mund te heq dore nga kontrata me njoftim me shkrim jo me heret se 6 muaj, perpara skadimit te polices te vitit aktual ose ne vijim.

Neni 10, Përlllogaritja dhe axhustimi i Primit te Sigurimit. Pasojat e mospagimit te tij, Kthimi i Primit të Sigurimit.

- (1) Përlllogaritja e primit të sigurimit bëhet sipas metodave te tarifimit të përcaktuara nga Siguruesi, si edhe në funksion të informacionit dhe të dhënave të deklaruara nga i Siguarari.
- (2) Në rastin kur përlllogaritja e primit bazohet mbi vlerën e qarkullimit monetar të veprimtarisë së të Siguararit për një periudhë të caktuar kohe, ky prim i nënshtrohet axhustimit. Primi i Sigurimit axhustohet jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të periudhës së sigurimit në varësi të ndryshimit të vlerës së qarkullimit monetar të të Siguararit, nëse nuk parashikohet ndryshe në policë. Diferencat aktive dhe pasive të axhustimit të primit duhet të kryhen nga palët brenda 15 ditëve nga përcaktimi i kesaj vlere.
- (3) Primi i sigurimit paguhet njëherësh ose me këste.
- (4) Përgjegjësia e Siguruesit te paguaje demshperblim per humbjen ose demin perfundon ne rastin e mospagimit te primit të sigurimit, kështit te pare ose te radhes brenda afatit prej 15 ditësh duke filluar nga data e maturimit të pagesës së tij shënuar në policën e sigurimit, si edhe sipas parashikimeve te Nenet 9, pg.3 – per rinovimin me siper, afat i cili skadon në orën 24.00 të ditës së 15-të. Vertetimi i faktit te mospageses se primit si parishikuar ketu, zgjidh automatikisht Kontratën e Sigurimit, pa patur nevojte per njoftim tjetet te veçante nga Siguruesi.
- (5) I Siguarari është përgjegjës për pagesën e primit, kështit dhe/ose diferencës aktive të tij edhe në ato raste kur ai pretendon, që Siguruesi nuk e ka njoftuar për datat e maturimit.
- (6) Në rast të ndërprerjes së njëanshme të Kontratës së Sigurimit nga palët, primi i paguar i kthehet të Siguararit në perpjesim me kohën që mbetet deri në mbarim të afatit ose periudhes se mbulimit të kontratës se sigurimit, duke zbritur shpenzimet administrative përkatëse. Kthimi i primit ndalohet në këto raste:
 - 1) kur i Siguarari ka përfutuar ose do te perfitoje cdo demshperblim nga Siguruesi, pavaresisht vleres se tij;
 - 2) kur kerkesa per kthim primi behet me vone se dy muaj nga përfundimi i afatit te vlefshmërisë së kontratës të përcaktuar në policë.

Neni 11, Detyrimet e Paleve me ndodhjen e nje Rasti Sigurimi

A. Detyrimet e te Siguararit

- (1) Të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet e mundshme për minimizimin e pasojave të demit/ve te shkaktuara nga ngjarja aksidentale;
- (2) Të njoftojë menjëherë Siguruesin per ndodhjen e aksidentit (ngjarjes se papritur). Nese nje hetim per kundravajtje penale ose civile fillon ose ka shenja (indicie) qe do te filloje kunder te Siguararit ose personave per te cilet ai (i Siguarari) eshte përgjegjes njofton menjehere Siguruesin pavaresisht se kishte njoftuar me pare per ndodhjen e te njejtës ngjarje sigurimi;
- (3) Nese i Siguarari merr nje kerkese per demshperblim nga te tretet ose veprime lidhur me demet kane filluar kunder tij, i Siguarari duhet te njoftoje menjehere Siguruesin dhe ti paraqese atij te gjitha dokumentet qe lidhen me kerkesen/at per demshperblim;
- (4) Të lejojë dhe ti jape fuqi ligjore perfaqesimi Siguruesit apo juristit te caktuar prej tij qe te drejtoje veprimet ligjore qe lidhen me ngjarjen e sigurimit, pasojat dhe zgjidhjen e saj. Nese i Siguarari nuk lejon Siguruesin te drejtoje zgjidhjen e kerkeses/ave per demshperblim, Siguruesi nuk eshte përgjegjes te paguaje kostot ekstra te kerkeses per demshperblim, interesat apo shpenzimet ligjore e te tjera te lidhura me te.
- (5) Në pajtim me detyrimin e përcaktuar ne paragrafin (4), me siper te mos refuzoje dhe per me teper te mos pranoje asnje kerkese per demshperblim te ardhur nga te tretet.

B. Detyrimet e Siguruesit

- (1) Ti dorezoje te Policembajtesit ose te Siguararit kushtet e vlefshme te sigurimit qe perbejne ose konsiderohen pjese e kontrates se sigurimit.
- (2) Të kontrolloje kerkesat per demshperblim si lidhur me përcaktimin e përgjegjësise ashtu edhe vleren e demit ose humbjes, si dhe te siguroje mbrojtjen e te Siguararit nga kerkesat e pajustificuara ose te egzagjeruara nga te tretet.
- (3) Të mbuloje shpenzimet dhe kostot ligjore te te Siguararit te vendosura ne favor te te treteve, vetem nese Siguruesi ose personi i autorizuar prej tij drejton veprimet e nevojshme ligjore prej momenteve te fillimit te zgjidhjes ligjore te kerkeses per demshperblim. Cilado qofte vlera e ketyre

sherbimeve deshperblimi përfundimtar per deme e sende se bashku me shpenzimet e kostot ligjore nuk kalojne shumen e sigurimit te përcaktuar ne police. Po keshtu Siguruesi mbulon edhe shpenzimet e kostot ligjore te çeshtjes penale te ngritur kunder te Siguararit, kur merr persiper shprehimisht te beje avokatin mbrojtjes te te Siguararit. Edhe ne kete rast vlera totale e demshperblimit perfshi kostot ligjore te çeshtjes penale nuk e kalon shumen e sigurimit te përcaktuar ne police.

- (4) T'i japë të Siguararit rekomandimet e nevojshme në bazë të të gjitha inspektimeve, ekspertizave dhe veprimeve të nevojshme për mbrojtjen e interesit të tij.

Nëse i Siguarari refuzon të pranojë rekomandimet e Siguruesit:

- 1) Siguruesi nuk ka detyrim të mëtejshëm për të mbrojtur interesat e tij; dhe
- 2) përgjegjësia e Siguruesit për dëme, në lidhje me limitin e dëmshperblimit, nuk do të tejkalojë ose do te kufizohet ne vlerën e dëmshperblimit të parashikuar nga ai (Siguruesi).
- (5) Te kompensojë të Siguararin në përputhje me këto kushte sigurimi jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i vendimit përfundimtar të formës së prerë të Gjykatës për ngarkimin me përgjegjësi të të Siguararit, minus pjesën e zbritshme të shenuar në policën e sigurimit.

Neni 12, Pasojat juridike të “dijenisë” dhe “njoftimit” për ngjarjen e sigurimit

Nëse vërtetohet që, i Siguarari ose Policembajtesi njoftojne Siguruesin, për një “ngjarje” ose “kërkesë për dëmshperblim” nga palët e treta, per te cilat janë në dijeni, që dëmtime të shëndetit dhe dëme në sende ndaj palëve të treta kanë filluar të shkaktohen ose janë shkaktuar përpara fillimit te periudhës së vlefshmërisë së policës, atëherë çdo vazhdim, ndryshim, perqeqesim ose përfundim i pasojave te demeve ne shendet dhe sende gjatë ose pas periudhës së vefshmërisë së policës, do të quhen të “ditura ose të njohura” përpara fillimit te periudhës mbulimit të kesaj police dhe Siguruesi çlirohet nga detyrimi i kompensimit.

Neni 13, Sigurime të Tjera

- (1) Nëse në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, ekziston nje ose disa polica te tjera ne fuqi per mbulimin e përgjegjësise te te Siguararit per të tille ngjarje, atehere Siguruesi i kesaj kontrate çlirohet ose nuk do te jete përgjegjes per mbulimin per humbjen e demte te çdo kerkese per demshperblim, perveç asaj vlere demi qe tejkalon shumen me te madhe te demshperblimit te pagueshem nder policat e tjera ne fuqi.
- (2) Ne rastin kur vlera e demshperblimit te përcaktuar ne kete police tejkalon vleren me te larte te demshperblimit te përcaktuar nder policat e tjera ne fuqi, atehere Siguruesi i kesaj police eshte përgjegjes per demshperblimin e te Siguararit per nje shume te barabarte me diferencen qe rezulton nga vlera e demshperblimit per nje ngjarje sigurimi te përcaktuar ne kete police me vleren e demshperblimit me te larte te vertetuar nder policat e tjera te sigurimit, si parashikuar ne paragrafin (1) me siper.

Neni 14, Përfundimi dhe zgjidhja e kontratës

Kjo kontratë sigurimi:

- 1) përfundon kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe Siguruesi ka dëmshperblyer të Siguararin në limitin agregat të përcaktuar në policën e sigurimit;
- 2) zgjidhet menjëherë kur primi, kësti i radhes, primi i rinovimit ose vlera e axhustimit nuk janë paguar brenda 15 ditëve nga afati i maturimit të pagesës;
- 3) zgjidhet menjëherë kur Siguruesi njihet me të dhëna ose fakte të reja, që më parë janë fshetur ose deklaruar në mënyrë të rreme qëllimisht nga i Siguarari.
- 4) përfundon kur njëra nga palët shprehet në mënyrë të njëanshme për ndërprerjen e saj me njoftim paraprak 30 ditor. Ky njoftim do të quhet i kryer që në ditën e dërgesës së tij me postë.

Neni 15, Menyra e komunikimit, Ndryshimi i adreses

- (1) Te gjitha njoftimet e shpalljet qe duhet te paraqiten ose te jepen ne pajtim me parashikimet e Kontrates se sigurimit behen me shkrim.
- (2) Njoftimet e shpalljet konsiderohen se jane kryer ne kohe nese dergohen me leter te rregjistruar brenda afatit te parashikuar.
- (3) I Siguarari duhet te njoftoje Siguruesin per ndyshimin e emrit apo adresen e selise se kompanise. Nese i Siguarari ndryshon emrin apo adresen e kompanise dhe nuk njofton Siguruesin, eshte e mjaftueshme qe Siguruesi te dergoje njoftimet ne emrin dhe adresen e rezidencës se fundit te tij.

Neni 16, Ligji i aplikueshem, Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

- (1) Ligji i aplikueshem ne marredheniet ndermjet Siguruesit dhe te Siguararit, kur nuk zgjidhen nga përcaktimet e ketyre kushteve e termave te kesaj kontrate sigurimi, eshte Kodit Civil i Republikës se Shqiperise, përcaktimet dhe parashikimet e Pjeses se IV^{terrt} - Detyrimet dhe Kru XXIII - Sigurimet.
- (2) Në rastet kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.